



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 469/19 prot.

Datë 24.03.2026

V E N D I M
Nr.419/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.03.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të KPP nr. 365/2026, datë 09.03.2026, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-72023-12-12-2025, me objekt: “LOTI 2 Filtra deleukocitar dhe bashkues laborator për masat trombocitare”, me fond limit 18,960,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 15.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Fedos” SHPK me NIPT K01514009I dhe adresë: Rruga Kujtim Laro -Tirane, Nr pasurie 3/22,Kati 2, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqendruara me adresë Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “Albadent Group” SHPK me NIPT L62217032L dhe adresë: Rruga Allaman Dervishi, Pallati Classic A.M. Nr.31, Kthesa e Kamzës, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit

Publik”, Neni 4, i Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 09.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.365/2026 ku vendosi:

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Fedos” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-72023-12-12-2025, me objekt: “LOTI 2 Filtra deleukocitar dhe bashkues laborator për masat trombocitare”, me fond limit 18,960,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 15.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.*
2. *Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit “Albadent Group” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës që të kryejë veprimet përkatëse për ktihimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Fedos” SHPK SHPK .*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 4147 prot., datë 12.03.2026 protokolluar me tonën nr. 469/16 prot., datë 17.03.2026 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr.365/2026 datë 09.03.2026, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-72023-12-12-2025, me objekt: “LOTI 2 Filtra deleukocitar dhe bashkues laborator për masat trombocitare”, me fond limit 18,960,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 15.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara, duke i bashkëngjitur shkresës procesverbalin e rivlerësimit të KVO datë 12.03.2026.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1 Me shkresën nr. 4147 prot., datë 12.03.2026 protokolluar me tonën nr. 469/16 prot., datë 17.03.2026 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr.365/2026 datë 09.03.2026, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-72023-12-12-2025, me objekt: “LOTI 2 Filtra deleukocitar dhe bashkues laborator për masat trombocitare”, me fond limit 18,960,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 15.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara, duke i bashkëngjitur shkresës procesverbalin e rivlerësimit të KVO datë 12.03.2026.

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi veprimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, lidhur me zbatimin e vendimit Nr.365/2026 datë 09.03.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik. Nga ky verifikim rezultoi se, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësim të procedurës object ankimi, në zbatim të vendimit Nr.365/2026 datë 09.03.2026, të këtij komisioni.

Për sa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-72023-12-12-2025, me objekt: “LOTI 2 Filtra deleukocitar dhe bashkues laborator për masat trombocitare”, me fond limit 18,960,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 15.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

